



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

---

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike  
Mbledhja nr. 34  
Prishtinë, më 13.12.2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica dhe Evgjëni Thaçi-Drăgusha.

**Munguan:** Dukagjin Gorani, Sergjan Mitroviç dhe Zafir Berisha.

**Pjesëmarrës nga MDIS:** Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, me bashkëpunëtorët: Ejup Kamberaj, Burim Krasniqi, Shyhrete Gosalci dhe Lorik Pustina.

**Pjesëmarrësit e tjerë:** Jehona Krasniqi, KDI; Lira Haxhijakupaj, GERMIN dhe media.

**Nga zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 5 nëntor 2018;
3. Takim i komisionit me ministrin e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, z. Dardan Gashi;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.*

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 5 nëntor 2018**

*Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 5 nëntor 2018.*

### **3. Takim i komisionit me ministrin e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, z. Dardan Gashi**

**Vjosa Osmani-Sadriu**, falënderoi stafin e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike për bashkëpunimin që ia kanë ofruar komisionit, lidhur me organizimin e konsultimeve publike për ligjin e ri të diasporës. Më tej, njoftoi se në bashkëpunim me MDIS janë organizuar një sërë vizitash, ku kanë marrë pjesë disa deputetë të komisionit. Qëllimi i këtij takimi, me propozimin e ministrit Gashi, ka qenë që t'i marrim komentet finale para se MDIS ta dorëzojë Ligjin në Qeveri.

**Dardan Gashi**, tha se diaspora është temë kombëtare, e cila nuk është çështje vetëm e Qeverisë, as e një partie politike, por është çështje që i takon tërë spektrit politik si dhe gjithë aktorëve. Ministri njoftoi se janë vizituar 10 shtete ku i është dhënë mundësia diasporës dhe shoqatave të ndryshme të japin pikëpamjet e tyre sa i përket këtij projektligji. Falënderoi anëtarët e komisionit që kanë marrë pjesë në konsultimet publike dhe tha se shpreson se kur të procedohet projektligji në Kuvend, do të shkojë në mënyrë të koordinuar në benefit të diasporës. Ai, po ashtu, tha se pasi të miratohet ky ligj do të kemi mundësi të diskutojmë një temë kyçe për diasporën, që është kyçja e diasporës në jetën politike në Kosovë.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, njoftoi se është formuar një grup punues me nismën e deputetit Korab Sejdiu në Komisionin për Legjislacion, i cili ka hartuar një draft, që ka për qëllim ta ndryshojë Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, në kontekst të përmirësimit të së drejtës së votimit të diasporës. Po ashtu, theksoi se synimi i këtij grupi ka qenë që të rregullohen vetëm disa çështje të përgjithshme, kurse temat specifike do të rregullohen me akte nënligjore ose ligje të tjera.

**Time Kadrijaj**, falënderoi ministrinë për iniciativën që e kanë marrë për organizimin e konsultimeve publike dhe kështu është shkurtuar ndoshta koha e procedurave të shqyrtimit të ligjit, pasi që i kemi përmbledhur bashkërisht aktivitetet. Në konsultimet publike, tha se i kemi marrë komentet dhe sugjerimet dhe në punëtorinë që është mbajtur në Shqipëri, jemi munduar t'i përmbledhim të gjitha komentet që i kanë pasur bashkatdhetarët. Më tej, shtoi se ligji ka për qëllim të rregullojë diasporën, e cila ka dhënë një kontribut shumë të çmueshëm në të gjitha rrethanat dhe kjo është më e pakta që ne mund të bëjmë për ta. Me këtë ligj, po ashtu, rregullohen çështjet që janë të rëndësishme për diasporën, siç është ruajtja e gjuhës, kulturës etj.

**Glauk Konjufca**, tha se ky aktivitet ka qenë shumë më rëndësi, sepse në fokus është një temë shumë e rëndësishme, pra pritjet që Kosova ta ketë ligjin e përmirësuar për diasporën. Ai njoftoi se synimi i ministrisë ka qenë që në muajin dhjetor 2018, të përfundojë puna në këtë ligj, mirëpo sipas tij, një ligj i mirë për diasporën nuk do të mund të bëhet para muajit prill 2019. Sa i përket konsultimeve publike, njoftoi se nuk ka funksionuar mirë lidhja në mes Ministrisë së Diasporës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe mungesa e bashkëpunimit ka shkuar në dëm të kualitetit të tubimeve. Sa i përket mësimit plotësues në diasporë, Konjufca tha se shteti i Kosovës duhet të marrë përsipër të gjithë koston e shkollimit të fëmijëve të diasporës në gjuhën shqipe, këtë nuk e parashih ligji i ri. Në ligj duhet të definohet se shteti i Kosovës e merr përsipër barrën ligjore dhe financiare të shkollimit të gjithë fëmijëve të diasporës. Shprehu mendimin se nëse kjo nuk parashihet në ligj, atëherë nuk është bërë zgjidhja e duhur për diasporën. Më tej, shtoi se mund të jenë rreth 200 000 fëmijë, mirëpo jo për të gjithë këta fëmijë shteti i Kosovës mund të ketë kosto, sepse disa prej shteteve e mbulojnë këtë pjesë, siç është Suedia dhe disa lande të Gjermanisë. Ai më tej njoftoi për gjendjen e zhvillimit të mësimit plotësues në Itali, ku mësuesit punojnë në mënyrë vullnetare dhe atë pas përfundimit të punës

së tyre të rregullt. Sa i përket rregullimit të qendrave kulturore me atashe, tha se kemi një mospajtim të pjesëtarëve të diasporës. Ata e kanë si rezervë se mos po shndërrohet edhe kjo në një prej pozitive të emërimeve të politikës. Njoftoi se deri më tani qendrat kulturore e kanë pasur një bazë në komunitet, kurse tani me vendosjen e një njeriu nga Qeveria, ata e kanë një rezervë se mos po shkaktohen përçarje.

**Dardan Gashi**, njoftoi se qendrat kulturore, deri më tani, kanë qenë të udhëhequra nga persona që i ka emëruar Qeveria, pa kurrfarë procedure dhe ka qenë në dëshirën e ministrit se kë e emëron. Propozoi që kur të vijë puna e emërimit të atasheve, ne mund të ua sjellim në komision CV-të e tyre, nëse mendoni se është çështje e emërimit politik.

**Vjosa Osmani- Sadriu**, tha se nëse kjo çështje shkon nëpërmjet MPJ-së, ligji nuk e lejon involvimin e komisionit për atashe. Komisioni, me ligj, involvohet vetëm në rast të shfave të misioneve. Ajo, po ashtu, tha se roli i atasheut në momentin që formohet bordi ka do të jetë shumë i vogël dhe çështja është të organizohet deri në momentin kur ekziston bordi, pastaj kur të formohet bordi, gjithçka rregullohet nëpërmjet tij dhe funksionon me bazë në komunitet, ashtu siç ka qenë deri më tani.

**Dardan Gashi**, duke iu referuar fjalimit të deputetit Konjufca, tha se pikërisht problemet që i ceku sa i përket mosfunksionimit të bashkëpunimit në mes MPJ-së dhe MDIS-së, janë produkt i mungesës së identifikimit të sistemit diplomatik që është marrë në mënyrë specifike me diasporën. Njoftoi se konsulli që merret me çështjen e pasaportave është marrë edhe me çështjen e diasporës, në mënyrë vullnetare dhe ideja është që të kemi një trup të caktuar në ato vende ku kemi diasporë që të merret me çështjet e diasporës. Sa i përket arsimit dhe idesë për financim, tha se nëse e marrim një fakt që Banka Qendrore raporton që janë rreth 700 milionë të hyra në vit nga diaspora, unë duhet ta bind Kuvendin që të nxjerrë një vendim që 1% nga këto të hyra që të jenë për aktivitetet për diasporën.

**Glauk Konjufca**, tha se remitencat e diasporës nuk janë pjesë e buxhet të Kosovës, pasi që këto janë të dedikuara për familjet e pjesëtarëve të diasporës. Ai shtoi se MDIS duhet të bëjë një analizë të saktë se sa nxënës janë në diasporë dhe kur të vijë tek numri i saktë i nxënësve e përkthen në numër të mësuesve, atëherë dihet edhe kostoja buxhetore përfundimtare që shteti i Kosovës zotohet që do të marrë barrë për shkollimin në gjuhën shqipe të nxënësve në diasporë.

**Vjosa Osmani- Sadriu**, duke iu referuar projektligjit, pika 1.4 e nenit 7, thotë: “Në shtetet pritëse ku mësimi i gjuhës amtare nuk është i integruar në sistemin e rregullt arsimor, në pajtim me legjislacionin e shtetit pritës, Ministria ose Qeveria organizon mësimin plotësues për pjesëtarët e diasporës”, këtu mund të shtojmë: “organizon dhe merr përsipër obligime ligjore dhe financiare për mësimin plotësues për pjesëtarët e diasporës”. Në aspektin juridik, do të rregullohej brenda kësaj pike.

**Dardan Gashi**, njoftoi se me Republikën e Shqipërisë kanë marrëveshje për financimin e arsimit plotësues shqip dhe ka ngecje në anën e Republikës së Shqipërisë, të njëjtin problem e kanë edhe me qendrat kulturore. Ai, po ashtu, njoftoi se e kanë pak a shumë numrin e saktë të mësuesve, të cilët i takojnë rregullisht dhe mund të sjellë detaje, sa i përket numrit të mësimdhënësve, nevojat që i ka arsimit jo vetëm në Evropë, por edhe në Amerikë, Australi e Kanada, ku ne i furnizojmë atë sa mundemi me libra dhe aktivitete.

**Fitore Pacolli**, falënderoi ministrin dhe stafin e ministrisë për komunikimin që e kanë pasur me deputetët, sa i përket vizitave të realizuara në Evropë dhe Amerikë dhe njoftoi se ka marrë

pjesë në shumicën prej vizitave dhe ka identifikuar disa probleme kryesore, sa i përket organizimit të vizitave. Ajo tha se ftesat për konsultimet publike janë shpërndarë vonë, qytetarët janë njoftuar me vonesë. Problem tjetër, tha se është mosinformimi me kohë dhe i drejtë i mërgatës. Këto diskutime janë quajtur diskutime publike, që nënkupton që janë të hapura për tërë publikun dhe njoftimi duhet të bëhet në mënyrë publike përmes mediave, televizionit publik, gazetave dhe mjeteve të tjera të informimit. Më tej, njoftoi se në Vjenë, Londër, Paris, Lion dhe Bruksel, diskutimet publike kanë dështuar, për shkak se njoftimi është bërë shumë vonë, në disa raste njoftimin është bërë vetëm në faqen e MDIS dhe në disa raste nuk ka pasur fare njoftim. Sa i përket diskutimit publik në Turqi, njoftoi se shumica e diasporës shqiptare atje nuk e flasin gjuhën shqipe dhe projektligji është dashur të dërgohet në gjuhën turke dhe jo në gjuhën shqipe. Më tej, Pacolli shtoi se mungesa e koordinimit me MPJ-në dhe shërbimin e jashtëm, ka ardhur si pasojë se ambasadat janë informuar shumë vonë nga MDIS, për këto konsultime publike. Duke iu referuar projektligjit, të cilin e ka sjellë MDIS, tha se nuk janë marrë parasysh kërkesat e diasporës, është pothuajse i njëjti. Lidhur me qendrat kulturore, Pacolli tha se gjatë diskutimeve është kundërshtuar mënyra e propozimit të një atasheu, caktimi i tij përmes ministrisë, zgjedhja e tij në mënyrën se si zgjedhën ambasadorët. Kjo është konsideruar si kontroll i diasporës, përmes këtyre qendrave. Ajo propozoi që këto qendra të largohen nga projektligji, derisa të kemi një model konkret sesi do të themelohej një qendër kulturore. Sa i përket buxhetit të këtyre qendrave, duke iu referuar një komenti të një zyrtar të MDIS që 100 mijë euro po i japim për këto qendra, por i kthejmë 1 milion, tha se ne nuk e kemi ndonjë dokument që na sqaron se si kthehen 1 milion euro në Kosovë. Sa i përket komunikimit me diasporën, njoftoi se projektligji në këtë çështje nuk ndryshon asgjë. Ne e kemi parë që komunikimi me diasporën, sa i përket MDIS dhe kanaleve të saj, ka dështuar. Për hapjen e kanalit televiziv për diasporën, Pacolli njoftoi se anëtarët e diasporës nuk kanë kërkuar kanal të veçantë dhe nuk e kanë përkrahur këtë ide. Kërkesa e tyre ka qenë që RTK të respektojë 6-9% të hapësirës, të cilën e ka obligim ligjor. Pyeti ministrin nëse ka pasur konfirmim për takim me drejtorin e përgjithshëm të "British Council", nëse ka pasur, atëherë pse e ka anuluar për një kohë shumë të shkurtër?

**Dardan Gashi**, tha se fakti që nuk ka pasur pjesëmarrje tregon se nuk është puna mirë me organizimin e diasporës, përndryshe nuk kishte pasur nevojë as për ligj, as për këtë takim. Ne të gjithë po konstatojmë se nuk është mirë dhe po kërkojmë një mënyrë sesi të bëhet më mirë. Po ashtu, tha se projektligji nuk është perfekt, porse janë duke u koncentruar sesi ta bëjnë këtë ligj më funksional, në favor të diasporës, e jo në favor të popullzimit politik.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, njoftoi se ligji nuk i është proceduar zyrtarisht Kuvendit, nëse ministri i merr parasysh disa prej gjërave që i thanë deputetët, para se ta dorëzojë në Qeveri, do të ishte shumë mirë. Më tej, shtoi se e ka thënë si koment të përgjithshëm, që për çështjet që është vështirë të rregullohen me një dispozitë të vetme, për shkak të ligjeve dhe situatave në shtetet ku kemi diasporë, është më mirë që dispozita ta ketë tekstin shumë të përgjithshëm, e pastaj të rregullohet me akte nënligjore për situata konkrete.

**Fitore Pacolli**, duke iu referuar diskutimit të ministrit, se situata është keq, pyeti se si është informuar diaspora për të marrë pjesë në konsultimet publike. Pse nuk është bërë njoftimi përmes RTK-së?

**Ejup Kamberaj**, njoftoi se MDIS, konform legjislationit në fuqi, ka bërë konsultimin e brendshëm dhe pas përfundimit të atij procesi ka filluar konsultimi publik me diasporën. Këto komunikime kanë qenë të shpallura në portalet zyrtare të Qeverisë dhe MDIS. Duke iu referuar nenit 12.6, lidhur me proceset e organizimit të mësimit plotësues dhe përzgjedhjes së

arsimtarëve, tha se për shkak të problemeve grumbulluara dhe të paidentifikuara deri më tani, është lënë që të rregullohet me rregullore të brendshme me MASHT. Sa i përket qendrave kulturore, tha se qëllimi ka qenë që të reflektojë sadopak dora e shtetit në këtë mekanizëm. Po ashtu, njoftoi se përzgjedhja e drejtorit në këto qendra do të bëhet me konkurs transparent dhe publik dhe pozita e drejtorit do ta ketë gradën diplomatike atashe, për shkak të lehtësirave që i ka në shtetin pritës.

**Evgjeni Thaçi- Dragusha**, theksoi se projektligji i ri për diasporën ende nuk i është proceduar Kuvendit për shqyrtim, po ashtu edhe ftesës për pjesëmarrje në dëgjime lidhur me këtë draft i është përgjigjur një pjesë e deputetëve, të cilët do ta japin kontributin e tyre me rastin e shqyrtimit të projektligjit në fjalë. Edhe komisioni, gjatë shqyrtimit të projektligjit, ka të drejtë të organizojë dëgjime publike dhe ta begatojë projektligjin. Disa nga çështjet e projektligjit, tha se duhet të shqyrtohen më gjerësisht, që të bëhet zgjidhja e duhur lidhur me arsimin dhe kanalën televiziv të diasporës.

**Doruntina Maloku- Kastrati**, lidhur me funksionimin e qendrave kulturore, tha se në secilin shtet ka kërkesa të veçanta, prandaj propozoi që në njërin nga pikat e nenit 9 të rregullohet funksionimi i QKD-së, konform nevojave dhe karakteristikave të mërgatës në shtetin pritës, varësisht nga shtetet. Pika 2 e nenit 16, propozoi që të riformulohet si vijon: njëri nga kanalet ekzistuese televizive të RTK-së, t'i dedikohet komplet programit të veçantë për diasporën.

**Dardan Gashi**, lidhur me kanalën televiziv për diasporën, tha se është një keqkuptim, ngase nuk është paraparë hapja e një kanali të ri, por një program i dy shteteve, atij të Shqipërisë dhe të Kosovës, për diasporën.

**Elmi Reçica**, theksoi se pavarësisht vetë ligjit, zgjidhja më e duhur lidhur me të gjitha çështjet për diasporën do të ishte që të kontaktojmë të gjitha vendet ku ka shqiptarë dhe të krijojmë bashkësinë shqiptare të diasporës. Më tej, tha se nuk është për t'u ngutur për ta miratuar ligjin. Po ashtu, dëgjimet publike jashtë vendit kanë qenë të ngutura, por sigurisht se ministria është përpjekur që të jetë në harmoni me planin legjislativ. Formimi i bashkësisë shqiptare të diasporës, çështja e ruajtjes së integritetit, çështja e investimeve strategjike të diasporës, kërkojnë zgjidhjen më të mirë të mundshme, të cilën duhet ta bëjmë, pa pasur nevojë të ngutemi me miratimin e ligjit.

**Fitore Pacolli**, propozoi që neni 20, 21 dhe 26, që kanë të bëjnë me përmbledhjen e të dhënave për diasporën, të inkorporohen në një nen të veçantë, që është edhe kërkesë e diasporës, shtoi ajo. Lidhur me dëgjimin publik në Suedi, tha se diaspora është ankuar se qendra kulturore në Malmë është bastion i PDK-së dhe ka konflikt interesi, në këtë drejtim.

**Dardan Gashi**, lidhur me diskutimin e deputetes Pacolli, theksoi se qendrat kulturore janë mbyllur dhe në Suedi nuk ka qendra kulturore as të PDK-së, as të LDK-së e as të VV-së.

**Time Kadrijaj**, falënderoi ministrin për organizimin e dëgjimeve publike nga MDIS, për këtë projektligj, por e keqja më e madhe tha se është tentimi që të politizohet diaspora. Pasi që projektligji do të vijë në komision për shqyrtim, theksoi se komisioni e ka të drejtën që të organizojë dëgjime publike dhe ta plotësojë e ta ndryshojë atë.

**Vjosa Osmani -Sadriu**, theksoi se është mirë që në Projektligjin për Diasporën. deri diku, është lënë një hapësirë dhe hap rrugën edhe për investime strategjike, që pas këtij projektligji, hapi i dytë të jetë ndryshimi i Ligjit për investimet strategjike, në mënyrë që kontributi i

diasporës të shfrytëzohet për zhvillim të Kosovës e mos të mbetet vetëm si investim familjar. Lidhur me marrëveshjet dypalëshe me Shqipërinë, kërkoi që zyrtarisht t'i përcillen komisionit, po ashtu edhe marrëveshjet me shtete të tjera, nëse ka MDIS.

Me rastin e fillimit të hartimit të drafteve, tha se do të ishte mirë që në konsultim me zyrën e MPJ-së për traktate dypalëshe dhe shumëpalëshe, të identifikohen se cilat janë ato shtete apo lande, me të cilat ka nevojë të lidhen marrëveshje dypalëshe, në mënyrë që të rregullohet çështja e mësimit plotësues apo çështje të tjera. Lidhur me atasheun, pyeti nëse me rastin e fillimit të përzgjedhjes së tyre a do t'i jepet përparësi pjesëtarëve nga diaspora apo do të bëhet e obligueshme që personi që zgjidhet, të jetë pjesëtar i diasporës.

**Dardan Gashi**, tha se sa i përket aspektit ekonomik të diasporës, jemi dakorduar me Ministrinë e Tregtisë, që 25% e zonave industriale që janë në themelim e sipër, të dedikohen për diasporën. Sa i përket investimeve strategjike, tha se shpreson që të kemi mirëkuptim, që të ulen kriteret e shumës së investimit strategjik për diasporën, e jo kriteret e tjera. Ndërsa, sa i përket atasheut, ministri tha se ekskluzivisht duhet të jetë nga diaspora, jo vetëm për shkak të shpenzimeve, por që të jetë pjesëtar nga komuniteti që jeton atje.

#### 4. Të ndryshme

**Vjosa Osmani**, tha se për shqyrtimin e draft-strategjisë jemi njoftuar përafërsisht para 1 muaj e gjysmë dhe kemi angazhuar ekspertin Qerim Qerimi, i cili për shkaqe shëndetësore nuk ka arritur ta hartojë ekspertizën. Po ashtu, theksoi se draft-strategjia që na është përcjellë, është një dokument i dobët dhe 80 % e tij, është kopjim i fushëveprimeve të institucioneve, që i bie se nuk është strategji për marrëdhënie ndërkombëtare, por për bashkëpunim ndërinstitucional. Në vazhdim, tha se me përkrahje të komisionit, në këtë draft, do të bëjë disa ndryshime, të cilat më pas do t'i propozojë në mbledhjen e radhës së komisionit për miratim, në mënyrë që të finalizohet kjo pikë, sipas PKZMSA-së. Njëkohësisht, tha se në këtë draft janë të propozuara disa shtojca, të cilat duhet të fshihen e po ashtu edhe të ndryshohet emërtimi i draftit. Më te, theksoi se nuk na takon neve si komision që t'i caktojmë detyrat e Drejtorisë për Protokoll e Marrëdhënie Ndërkombëtare, ngase është çështje e sekretarit të Kuvendit. Në arsyetimin, lidhur me këtë strategji për t'ia përcjellë Kryesisë, tha se do të duhet të ceket se komisioni po e përcjellë për miratim strategjinë për bashkëpunim ndërinstitucional, ndërsa duhet kërkuar, që komisioni të autorizohet për ta hartuar gjatë kësaj legjislature strategjinë për bashkëpunim ndërkombëtar e ndërparlamentar. Propozoi që me pëlqimin e komisionit, të bëhen ndryshime në këtë strategji dhe në titullin e dokumentit, kurse të hënën, në mbledhjen që do të ftohet, komisioni ta miratojë atë.

**Evgjeni Thaçi- Dragusha**, njoftoi se raporti nga monitorimi i zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën është hartuar para dy muajsh, mirëpo ka dështuar disa herë të takohet grupi punues, për shkak të angazhimeve me vizita dhe çështje të tjera. Njoftoi se në bashkëpunim me deputeten Pacolli, u morën vesh ta hartojnë një pyetësor lidhur me zbatimin e ligjit për shoqatat në diasporë, por theksoi se nuk kanë marrë ndonjë përgjigje për dy muaj. Propozoi që komisioni të trajtojë raportin nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën ose grupi punues të mbledhet edhe një herë që t'i shqyrtojë edhe disa çështje tjera.

Komisioni, pas diskutimit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën, nxori këtë:

## *Përfundim*

*Raporti me rekomandime nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së komisionit dhe të mbetet si dokument bazë me rastin e shqyrtimit të Projektligjit të ri për Diasporën.*

**Vjosa Osmani- Sadriu**, njoftoi anëtarët e komisionit, lidhur me mungesën e raportimit të ministrit Pacolli në komision, si dhe për ftesën e fundit që i është bërë për raportim të fund vitit, me mundësi të zgjedhjes së 2-3 datave për raportim gjatë muajit dhjetor.

**Elmi Reçica**, si anëtar i grupit punues, njoftoi se lidhur me Interpolin është punuar në heshtje dhe nuk kanë dalë me deklaratë, në mënyrë që të mos e mobilizojnë palën kundërshtare. Sa i përket raportimit të ministrit Pacolli, tha se komisioni duhet të insistojë që ministri të raportojë në komision për fund vit, përkundër lëvizjeve që i ka.

**Vjosa Osmani- Sadriu**, theksoi se fushëveprimi i komisionit është trefishuar dhe komisionit i nevojiten njerëz të specializuar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, në fushën e diasporës dhe atë të investimeve strategjike dhe propozoi që të rritet numri i stafit edhe për 2 anëtarë.

**Elmi Reçica**, njoftoi se është një ide e kamotshme që Drejtoria për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Protokoll, të ndahen dhe për këtë ka bërë kërkesë edhe te sekretari i Kuvendit.

**Vjosa Osmani- Sadriu**, theksoi se në këtë draft-strategji mund të parashihen këto propozime për shtimin e numrit të stafit edhe për 2 anëtarë dhe për ndarjen e Drejtorisë për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Protokoll, në dy drejtori. Më tej, njoftoi se ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit, që për shkak të natyrës së KPJDIS dhe KIE, kërkesat për vizita zyrtare të mos shqyrtohen në procedurë të njëjtë, sikurse kërkesat e tjera që parashtrihen, por të kenë përparësi në shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Kryetarja e komisionit,

---

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:  
Njësia për mbështetjen e komisionit.